

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 402/2006  
8 shtator 2009  
Prishtinë

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e formuar në përputhshmëri me nenin 26, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji mbi Kompetencat), dhe të përbërë nga:

- Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, Kryetar dhe gjyqtar raportues,
- Maria Giuliana Civinini, Gjyqtare e EULEX-it, anëtare e kolegjit,
- Emilio Gatti, Gjyqtar i EULEX-it, anëtar i kolegjit,
- Avdi Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, anëtar i kolegjit dhe
- Agim Krasniqi, Gjyqtar i Gjykatës Supreme, anëtar i kolegjit,

Të ndihmuar nga Judit Eva Tatrai, Zyrtare Ligjore e EULEX-it, si procesmbajtëse, Vlora Johnston, dhe Sonila Macneil procesmbajtëse të EULEX-it, Arlinda Gjebrea, Nexhmi Rexhepi dhe Anamarija Richter përkthyes të EULEX-it;

Në prani të Prokurorëve Publik, Anette Milk Prokurore e EULEX-it dhe Bademe Sllamniku Prokurore Publike e Shtetit, Avokatit Mbrojtës Enver Nimani dhe të pandehurit G


Në seancën e mbajtur më 8 shtator 2009, pas këshillimeve të kolegjit të përfunduara në po këtë ditë;

Në rastin penal kundër:

G F

I akuzuar për dy pika të Vrasjes së rëndë, të përcaktuara dhe të dënueshme me nenin 30 paragrafin (2) pikat 2) dhe 3) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), në lidhje me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ), lidhur me nenin 147 pikat 4) dhe 6) dhe nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe katër pika të Vrasjes së Rëndë në Tentativë, të përcaktuara dhe të dënueshme me nenin 30 paragrafin (2) pikën 6) të LPK-së, në lidhje me nenet 22 dhe 19 të KP RSFJ-së, lidhur me nenin 147 paragrafin 10 dhe nenet 20 dhe 23 të KPK-së;

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 402/2006  
Gëzim Ferati



Duke vendosur mbi ankesën e Prokurorit Publik të paraqitur në dëm të të pandehurit kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 716/2005, të datës 11 maj 2006;

Pas shqyrtimit të të dhënave të gjykatës, dëgjimit të argumenteve të Prokurorit Publik, të Avokatëve Mbrojtës dhe të pandehurit, dhe pas analizës së Ligjeve përkatëse;

Në pajtim me nenin 423 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

Ankesa e Prokurorit Publik e paraqitur në dëm të të pandehurit **REFUZOHET si e pabazuar**, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 716/2005, i datës 11 maj 2006 **VËRTETOHET**.

### ARSYETIMI

Procedura:

Ankesa e Prokurorit Publik e paraqitur me kohë më 24 korrik 2006, kundër aktgjykimit të shpallur më 11 maj 2006 që liroi të akuzuarin G F , është e pranueshme.

Seanca publike e Gjykatës Supreme, për të cilën të gjitha palët janë ftuar me kohë përfshirë edhe palët e dëmtuara, është mbajtur më 8 shtator 2009; palët e dëmtuara kanë munguar.


Prokurorja publike ankimoi aktgjykimin në dëm të të pandehurve, në bazë të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale*, kryesisht në formë të *vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*.

Duke mbështetur ankesën e saj, prokurorja publike argumenton se gjykata e shkallës së parë e liroi të pandehurin për shkak të mungesës së dëshmitarëve okularë që do të mund të identifikonin të pandehurin si njërin nga bashkëkryerësit. Ajo konstaton se dëshmitë fizike, pra arma që ishte konfiskuar nga i pandehuri e që përputhej me gëzhojat e kalibrit 7.62 të gjetura në vendin e krimit, peshon më shumë se mungesa e dëshmitarëve okularë dhe duhet të bindë kolegjin përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në fakt ishte njëri nga bashkëkryerësit.

Së dyti, prokurorja publike mendon se aktgjykimi sugjeron se nëse gjashtë gëzhojat ishin gjetur në vendin e krimit pesë ditë pas incidentit, atëherë vihet në dyshim nëse ato faktikisht ishin shkrepur në vendin e krimit natën e 17 marsit 2004. Prokurorja publike është e mendimit se pasi që i pandehuri tërë kohën ishte në posedim të armës së përmendur që prej blerjes së armës deri në konfiskimin e tanishëm, mund vetëm të përfundohet se gjashtë gëzhojat e kalibrit 7.62 e lidhin armën me vendin e krimit.

Më tutje, prokurorja publike nuk pajtohet me konstatimet e aktgjykimit se inspektimi i vendit të krimit nuk ishte korrekt dhe i besueshëm. Siç argumenton prokurorja publike, fakti që policët të cilët janë marrë me vendin e krimit nuk ishin të trajnuar për inspektim të vendit të krimit dhe nuk ishin të pajisur me pajisje të duhura nuk e bëjnë të dyshimtë rezultatin e

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 402/2006  
Gëzim Ferati



hetimeve të vendit të krimit. Mund vetëm të shpjegojë pse ata nuk kanë mundur ti gjejnë të gjitha gëzhojat herën e parë.

Prokurorja publike përfundon se pasi që G. F. pranoi se kishte në posedim armë gjatë tërë kohës, kjo armë e lidhë atë me vendin e krimit ku ishte shtënë në drejtim të D dhe B. S duke shkaktuar vdekjen e tyre, dhe rrezikimin e jetës së V S, dhe tentimin e vrasjes së katër policëve serbë të PK-së.

Duke u bazuar në këto argumente, prokurorja publike shtyri kolegjin e Gjykatës Supreme të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë duke shpallë G. F. fajtor për akuzat, apo përndryshe të kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.


Prokuroria Publike e Shtetit qëndroi pjesërisht pranë ankesës së prokurores publike dhe shtyri Gjykatën Supreme të anulojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe të kthejë lëndën për rigjykim për këto arsye.

ZPPK-së argumenton që gjetjet e gjykatës se kanë qenë dëshmi të pamjaftueshme në mbështetje të përgjegjësisë penale të të pandehurit është për shkak të dështimeve të tij personale për ti vërtetuar faktet saktësisht dhe plotësisht. Ajo i referohet precedentëve të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap.Kz. Nr. 91/2002 dhe Ap.Kz.Nr. 514/03), dhe përfundon që "in dubio pro reo" do të thotë gjendje e pasigurisë e cila ka mbetur pasi që janë shfrytëzuar mjetet në dispozicion të dëshmitëve. ZPPK është e mendimit që prokuroria ka vërtetuar në mënyrë të suksesshme lëndën *prima facie* kundër të pandehurit. Pranimi i tij personal që ka qenë në posedim të vazhdueshëm të armës është dashur ta sjellë gjykatën në përfundim që ai ka përgjegjësi penale për veprën penale kundër familjes S dhe Policëve Serb të PK-së.

ZPPK-së gjen që kolegji ka dështuar të siguroj veprime hetimore të mëtutjeshme për ta kompletuar gjendjen faktike dhe gjithashtu ka dështuar në vlerësimin e duhur të dëshmitëve të administruara. Kolegji gjithashtu ka gabuar kur ka refuzuar të gjitha propozimet e palëve për dëshmi të mëtutjeshme posaçërisht atë të avokatit mbrojtës lidhur me alibinë e të pandehurit pasi që do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në kredibilitetin e tij. Deklaratat e dëshmitarëve të alibisë (anëtarëve të familjes ose banorëve të së njëjtës shtëpi) gjithashtu do të mund të ndihmonin të vërtetohet nëse arma ka mundur të jetë në posedim të tjetër kujt në natën kritike.

ZPPK-ja shton që inspektimi i vendit të ngjarjes ishte siguruar dhe ishte bërë sa më parë që ka qenë e mundur. Edhe pse për Policin e PK-së D D ishte hera e parë e hetimit të vendit të ngjarjes, ai ka qenë në gjendje ta siguroj vendin, ka kërkuar gjurmët dhe ka fotografuar të gjitha të gjeturat. Prandaj, ZPPK-ja përfundon që bazuar në dëshmitë e Policëve Hetues të PK-së dhe ekspertëve të mjekësisë ligjore, është vërtetuar qartë që të gjitha gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes, dhe supozimi i gjykatës së shkallës së parë se disa nga gëzhojat kanë mundur të vendosen në vendin e ngjarjes me qëllim të keq, është i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me dëshmitë e administruara. ZPPK-ja tregon që arma është gjetur 8 muaj më vonë në posedim të të pandehurit dhe është bërë ekzaminimi balistik, prandaj nuk është e arsyeshme të besohet që dikush 8 muaj para zbulimit të armës së vrasjes

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 402/2006  
Gëzim Ferati



ka qenë në gjendje ti vendos me qëllim të keq gëzhojat në atë vend që do ta lidhnin armën dhe të pandehurin me vendin e ngjarjes.

Lidhur me datën kur janë gjetur gëzhojat e inkrimiuara, ZPPK-ja sqaron që gëzhojat e ekspozuara ndaj fenomeneve natyrore: shiut, diellit, ftohtit etj. për pesë ditë shtesë, do të jenë më të oksiduara se ato të mbledhura në ditën në vijim. Analizat e mëtutjeshme të mjekësisë ligjore do të zbulonin se kur janë gjetur 6 gëzhojat relevante. ZPPK-ja gjithashtu gjen që pamundësia për të ri-pozicionuar gëzhojat në vend dhe kontaminimi i vendit të ngjarjes nuk kanë ndikim relevant në përfundimin final të gjykatës, pasi që prokuroria nuk e ka bazuar rastin e saj në gjurmët e këmbëve të gjetura në vendin e ngjarjes. Fakti që gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes janë përputhur me armën e konfiskuar nga i pandehuri i cili gjatë gjithë kohës ka qenë në posedim të vazhdueshëm të armës, më tutje të vërtetuar me marrjen në pyetje të dëshmitarëve, Policët e PK-së dhe anëtarët e familjes së viktimës, fqinjëve zbulojnë situatën faktike të rastit.

Bazuar në këto arsye, ZPPK-ja tregon që procedura e rigjyimit do ti eliminonte mangësitë e sipërpërmendura dhe gjykata do të ishte në gjendje ti vërtetoj faktet plotësisht dhe saktësisht.

Faktet dhe konstatimet:

---


Pas rishikimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të aktgjyimit të ankimuar dhe pas analizës së ankesës së arsyetuar të Prokurorit publik, të përgjigjes së Mbrojtjes dhe të mendimit të Prokurorit publik, Gjykata Supreme konstaton:

- që gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar mirë faktet materiale që kanë ndodhur në mbrëmjen e 17 marsit 2004, të cilat rezultuan me vdekjen e D dhe B S
- që gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit dhe analizës së duhur të të gjitha dëshmimeve të prezantuara që janë mbledhur, ka vendosur në mënyrë të rregullt se nuk ka dëshmi të besueshme për të konstatuar pa dyshim të bazuar, praninë e vendit të krimit dhe pjesëmarrjen në çfarëdo cilësie të të akuzuarit në këtë krim. Duke vepruar kështu, gjykata e shkallës së parë ka theksuar me të drejtë mbledhjen e dyshimtë (joprofessionale) të dëshmimeve në vendin e krimit dhe mungesën e dëshmimeve të tjera të besueshme, të cilat mund ta lidhin të pandehurin drejtpërdrejtë me vrasjet për të cilat ai është akuzuar.

Gjykata Supreme nuk ndan mendimin e Prokurorit publik se gjykata e shkallës së parë ka mbështetur lirimin e G F vetëm në mungesën e dëshmitarëve okularë. Është e pakontestueshme se nuk kishte dëshmitarë okularë në ngjarjet e 17 marsit 2004 para shtëpisë së viktimave. Megjithatë, kjo nuk është arsyeja e vetme që çoi deri tek lirimi i të pandehurit nga të gjitha akuzat. Aktgjykimi i shkallës së parë, po ashtu, përmend inspektimin jo të drejtë të vendit të krimit, të bërë nga policia, gjë e cila edhe më tej ka përkeqësuar administrimin e provave, gëzhojave në këtë rast.

Për më tepër, Gjykata Supreme gjithashtu shpreh mospajtimin e saj me mendimin e prokurorit publik, sipas të cilit të gjashtë gëzhojat e gjetura në vendin e krimit pesë ditë të plota pas incidentit dhe pranimi i të pandehurit që ka poseduar armën gjatë tërë kohës provojnë pa asnjë dyshim se plumbat vërtetë janë shkrepur në vendin e krimit ose, për më

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kž. Nr. 402/2006  
Gëzim Ferati



teper, janë shkrepur nga vetë i pandehuri në natën e 17 marsit 2004. Gjykata Supreme nuk pajtohet me tezën e Prokurorit publik se raporti balistik së bashku me deklaratën e të pandehurve (duke thënë se pushka automatike AK47 kurrë nuk kishte dalë nga shtëpia e tij dhe kurrë nuk i ishte dhënë dikujt tjetër) dëshmon jo vetëm se i akuzuari ka gënjyer por gjithashtu se i akuzuari ka marrë armën e zjarrit, ka shkuar në vendin e krimit, ka hapur zjarr mbi viktimat dhe më vonë mbi policët. Kjo tezë e mbështetur në pikën e dyshimtë fillestare (gjetje/dëshmi të dyshimta) nuk mund të pranohet nga Gjykata.

Në këtë mënyrë Gjykata Supreme nuk pajtohet me mendimin e Prokurorit publik të shtetit se dëshmitarët e alibisë do të kontribuonin në plotësinë e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Vërtetë, është kontestuese se disa nga gëzhojat kanë mundur të vendosen në vendin e krimit me qëllim të keq për kompromis me të pandehurin tetë muaj para se arma e tij të bëhej e njohur për policinë. Megjithatë, mbi pesë vjet pas zbulimit të tyre, nuk ka më mundësi që ekzaminimet e mëtejshme mjekoligjore lidhur me korrozionin (ndryshkjen) e mundshme të gëzhojave do të zbulonin kohën e saktë apo ditën dhe vendin ku ata plumba janë shkrepur. Ky lloj ekzaminimi ka mundur të bëhet gjatë fazës së hetimeve.

Duke u mbështetur në këto arsye, Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë, në përputhje me nenin 3, paragrafin (2) të KPPK-së, me të drejtë ka liruar të akuzuarin.

Gjykata Supreme nuk ka gjetur bazë për mbrojtjen e argumentit të Prokurorit publik përkitazi me “vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike”, as lidhur me çfarëdo forme tjetër të “shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale”. Për këtë arsye, Gjykata Supreme refuzon ankesën dhe konfirmon aktgjykimin e ankimuar të shkallës së parë mbi lirim.

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**Ap.-Kz. Nr. 402/2006**  
**8 shtator 2009**  
**Prishtinë**

**Anëtarët e kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
**Emilio Gatti**  
Gjyqtar i EULEX-it


\_\_\_\_\_  
**Maria Giuliana Civinini**  
Gjyqtare e EULEX-it

\_\_\_\_\_  
**Avdi Dinaj**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

\_\_\_\_\_  
**Agim Krasniqi**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme  
Republika Kosovo

**Kryetari i kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
**Guy Van Craen**  
Gjyqtar i EULEX-it



**Procesmbajtëse:**

\_\_\_\_\_  
Autorizuar  
**Judit Eva Tatrai**  
Zyrtare Ligjore e EULEX-it

Aktgjykim  
Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 402/2006  
Gëzim Ferati